



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2021:074640
Datë: 17.04.2024
Numri i dokumentit: 05584184

C.nr.259/2021

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Betim Behluli, në çështjen juridike të paditëses Republika e Kosovës, Qeveria e Kosovës, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë, dhe Zhvillimit Rural, Agjencia Pyjore e Kosovës, Drejtorati Kordinues Rajonal, me seli në Prizren, kundër të paditurit H.Z.I, me banim në fshatin Llapqevë, Komuna e Malishevës, për kompensimin e dëmit, vlera e kontestit 218,28 €, jashtë shqyrtimit me dt.17.04.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M
PËR SHKAK TË PADEGJUESHMËRISË (MOSBINDJES)

MIRATOHET në tërësi kërkesë – padia e paditëses Republika e Kosovës, Qeveria e Kosovës, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë, dhe Zhvillimit Rural, Agjencia Pyjore e Kosovës, Drejtorati Kordinues Rajonal, me seli në Prizren, ashtu që të DETYROHET i padituri H.Z.I, me banim në fshatin Llapqevë, Komuna e Malishevës, që në emër të kompenzimit të dëmit t’ia paguaj shumën prej 218,28 €, me kamat ligjore prej 8%, nga dita e paraqitjes së padisë datë 07.04.2021, e gjerë te pagesa definitive, e të gjitha këto në afatin prej 15 ditëve nga dita e marrjes së Aktgjykimit, e nën kërcënim të përbarimit me dhunë.

A r s y e t i m

Pala paditëse në padi ka theksuar se i padituri bazuar në aktgjykimin K.nr.42/19, të datës 14.09.2020, me të cilin aktgjykim shpallet fajtor i pandehuri H.I, për shkak të veprës kundërvajtëse, nga neni 36,2 pika a, të Ligjit për Pyjet e Kosovës, nr.2003/3 si dhe Ligjit mbi ndryshim plotësimin e Ligjit për Pyjet e Kosovës me nr.2004/40 dhe konform nenit 35 të LMK-së.

Në bazë të provave si Aktgjykimi i Gjykatës Themelore Gjakovë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni për Kundërvajtje, K.nr.42/19, të datës 14.09.2020, i padituri është shpallur përgjegjës për shkak të kundërvajtjes nga neni 36,2 pika a, të Ligjit për Pyjet e Kosovës, nr.2003/3 dhe i njëjti është dënuar me gjobë.

Gjykata në kuptim të nenit 394 të Ligjit për procedurën kontestimore nr.38/2008 i publikuar në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës” me dt. 24.11.2021, i ka dërguar të paditurit padinë dhe Aktvendimin për dhënien e përgjegjës në padi.

Duke e bërë shikimin në flete dërgesën për dorëzim personal konstatohet se i padituri i lartpërmendur e ka pranuar personalisht Aktvendimin C.nr.259/21 të dt. 24.11.2021, padinë dhe provat me dt.07.12.2021, mirëpo edhe pse ka kaluar afati i paraparë për dhënien e përgjegjës në padi, i njëjti nuk e ka parashtruar përgjigjen në padi, andaj duke u bazuar në dispozitën ligjore të nenit 150.1 të LPK-së, të larte cituar Gjykata mori Aktgjykim për shkak të pa dëgjueshmërisë (mosbindjes) ndonëse janë plotësuar kushtet siç më poshtë vijojnë:

a) Të paditurit i është dorëzuar në mënyrë të rregullt padia, provat materiale dhe thirrja aktvendimi për dhënien e përgjegjës në padi,

b) Themelësia e kërkesë-padisë rezulton nga faktet e treguara në padi, dhe

c) Faktet mbi të cilat mbështetet kërkesë-padia nuk janë në kundërshtim me provat që i ka propozuar vet paditësi.

Andaj, në kuptim të nenit 160.6 të Ligjit për procedurën kontestimore janë dhënë vetëm arsyet e sipërcituara që e justifikojnë marrjen e këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC
C.nr.259/2021, më 17.04.2024

Gjyqtari
Betim Behluli

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve, nga dita e pranimimit të këtij aktgjykimi, ankesa paraqitet nëpërmjet të kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit, Divizioni Civil në Prishtinë.